

VENDIM
Nr. 381, datë 2.5.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR
MINISTRINË E FINANCIVE, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Financave, bëhet rishpërndarja e fondeve brenda programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, zëri “shpenzime kapitale”, të pakësohet fondi prej 8 (tetë) milionë lekësh.

b) Në programin buxhetor 01150 “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, zëri “shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 8 (tetë) milionë lekësh, për projektin “Implementimi i modulit të pagesave elektronike të doganës”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha